



**Shoqata 17shkurti.ch – 8152 Glattbrugg**

Sponsor gjeneral për 2009



**Agron Zahiri** (kryetar)  
**Mobili:** 076 712 52 72  
**E-Mail:** agron.zahiri@17shkurti.ch

**Data:** 28 shkurt 2010

## **Raporti i kryetarit në kuvendin e 4-të të përgjithshëm të shoqatës 17shkurti.ch**

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Më 15 mars 2009 mora besimin e juaj që për një vit ta udhëheqi shoqatën 17shkurti.ch . Në atë kohë ishin hapat e parë drejt një rruge me plot përgjegjësi, angazhim, vullnet dhe entuziazëm. Shoqata qysh në fillim mori një hov të madh duke realizuar projekte të shumta, kështu shoqata me një numër simbolik të anëtarëve mirpo duke fituar zemrat dhe besimin e qdo miresnjani që jeton në diasporë shtoi dukshëm numërin e anëtarëve. Në fillim shumë njerëz mendonin se nuk do të funksionojë shoqata dhe ishin skeptik në funksionimin e shoqatës, mirpo me punë të pa lodhshme dhe një dicitplinë të paparë për anëtarët e kryesisë erdhëm deri te kjo ku jemi sot.

### **MBLEDHJET E KRYESISË**

Gjat këtij mandati një vjeqarë kryesia e shoqatës mbajti gjithsejt 16 mbledhje të rregullta, pa i përmendur fare takimet e tjera jashta mbledhjeve zyrtare. Ka pasur raste ku për shkak të projekteve të shumta, të mbajmë mbledhje brenda një muaji 2 deri në 3 herë. Mbledhjet në shumicën e rasteve jan mbajtur të dieleve në klubin Iliria në Regensdorf.

### **NUMRI I ANËTARËSISË**

Shoqata u themelua me 17.02.2009 me një numër simbolik prej 10 personave, ku pastaj qdo ditë e më tepër shtohet numri i anëtarësisë. Sot pra shoqata numëron 118 anëtarë të vet, në mesin e tyre janë 16 të gjinisë femrore.

## **INFRASTUKTURA**

Shoqata posedon webfaqën e vet, ku për qdo ditë informon rreth aktiviteteve të shoqatës. Kjo është gjëja e cila shoqatës i jep një seriozitet dhe besueshmëri të madhe tek ne mireshjanët, sepse qdo hyrje dhe dalje është e regjistruar ne webfaqe. Shoqata poashtu ia mundëson çdo anëtarë me dëshirën e tij, të hapë një e-mail emri.mbiemri@17shkurti.ch

Për hirë të korrektësisë dhe publikimit më të shpejtë të të hyrave në webfaqe, që të mos presim deri në fund të qdo muaji për të dhënat e të hyrave, ne kemi marrë vendim të bëjmë shërbimin Postfinance. Ky shërbim nga Posta u tregua shumë i vlefshëm.

Shoqata 17shkurti.ch është liruar nga tatimet ndaj shetit të zvicerës, me kusht që nenet 3, 19 dhe 32 të ndryshohen (të plotësohen) dhe në këtë kuvend të përgjithshëm të miratohen.

Çdo anëtarë dhe sponzori i dërgohen fletëpagesa në menyre profesionale.

Shoqata ka në pronësi dy flamujë dhe dy banera ku shfrytëzohen për marketingun e shoqatës, në aksione dhe manifestime të ndryshme. Në kuadër të marketingut hyn edhe pllakata e shoqatës e vendosur në Miresh.

Aparati fotografik dhe ai për videoingjizime janë pjesë përbërëse e infrastrukturës së shoqatës, ku luajnë një rol shumë me rëndësi për arkivimin e aktiviteteve të ndryshme që ka kryer shoqata.

## **PROJKETET E REALIZUARA**

Gjatë vitit 2009 janë përfunduar mbi 20 projekte në fusha dhe lëmi të ndryshme. Për të kursyer kohën e juaj unë do ti përkujtojë vetëm disa prej tyre:

Shpërblimi i nxënësve

Ndërtimi i një shtëpie

Ndihmë për shërim të një bashkëqytetari

Shah-kopshti në parkun e fshatit

Bileta 1vjeqare për nxënësit nevojtarë dhe të shkëlqyer

Ndihma familjeve skamnore

..manifestime të ndryshme..

## **SPONZORËT**

Një nga vështirësitë e mëdha për funksionimin e shoqatës ishin gjetja e sponzorëve dhe duheshë të trokisja derë më derë sikur të isha një lypës për sigurimin dhe shtimin e buxhetit të shoqatës. Pa pasur parasysh mundin, ne arritëm të bindim shumë sponzorë të firmave shqiptare si dhe shumë firma zvicerane.

## **FOTOGRAFISTËT**

Kryesia e shoqatës i ka zgjedhur dy vullnetarë për fotografistë Rexhep Arifi dhe Besit Abdyli, të cilët kanë marrë për detyrë të fotografojnë dhe inxhizojnë çdo aktivitet që bën shoqata.

## **PËR KRYESINË**

Duke marr parasysh intenzitetin e projekteve, duheshin patjetër të mbaheshin mbledhje të shpeshta të kryesisë, dhe në këtë pikë jo shumë herë kam qen i knaqur me pjesmarrjen dhe angazhimin e të gjithë antarëve të kryesisë. Që në fillim e kam cekur, se „të jesh antar i kryesisë së shoqatës, duhesh të jesh i rregullt në mbledhje dhe angazhim e sakrific të madhe“ mirpo fatkeqësisht nuk e kam gjetur te të gjithë 10 antarët e kryesisë. Megjithatë nuk duhet t'ia humbim meritën qoftë edhe më të vogël që kanë dhënë në përgjithësi për shoqatën.

## **HARGJIMET E ANËTARËVE TË KRYESISË**

Anëtarët e kryesisë së shoqatës gjatë mandatit të tyre kanë pasur hargjime të shumta.

Shuma totale e cila është paguar nga anëtarët e kryesisë është CHF 2200.-, pra çdo anëtar i shoqatës ka qenë i detyruar të paguaj nga CHF 200.- ! Në kë shumë hyjnë çështjet administrative, webfaqja e shoqatës, vula e shoqatës, media, kamera digjitale etj. Kto janë hargjimet që janë të regjistruara, pra këto janë hargjime të kryesisë që janë paguar nga gjepi i tyre. Këtu nuk janë të cekur shumat që janë dhënë në shumë aksione. Duhet ta përmendi që ka pasur edhe hargjime të shumta të pa regjistruara jashtë këtyre CHF 2200.- dhe të paguara nga gjepi i tyre nga Avni Kastrati dhe Kryetari i shoqatës.

## **SI MUND TË FUNKSIONOJ SHOQATA SI SOT EDHE NË TË ARDHMEN**

Shoqata mund të funksionojë me këtë ritëm edhe në të ardhmëm,

nëse...

- në kryesi zgjidhen personat që mund të gjejnë kohë për çdo mbledhje
- çdo vit ndërrohen disa anëtar të kryesisë
- çdo vit kemi një kryetar të ri
- çdo anëtar i kryesisë është neutral ndaj politikës
- kryetari i ardhshëm mund të gjejë kohë të mjaftueshme dhe dinë ta udhëheq shoqatën
- kryetari mund ta mbajë vetë webfaqën e shoqatës
- kryetari është njëqindpërqind neutral ndaj politikës
- nëse çdo vit kemi rotacion për postin të kryetarit
- nënkryetari, arkatari dhe sekretari janë krahë i djathtë i kryetarit
- çdo hyrje-dalje regjistrohet në webfaqe
- nëse çdo anëtar i kryesisë koncentrohet të kontribuoj për një vit
- kemi anëtar të rinjë, që janë të gatshëm të kontribuojnë për një vit në kryesi

## **PËRFUNDIMI I MANDATIT NJË VJEQARË**


Për mua viti që kaloj ka qenë sakrificë, mund dhe angazhim pore dhe krenari. Në kuvendin e kaluar kam dashur ta marrë besimin tuaj për ta udhëhequr shoqatën 17shkurti.ch për një vit. Unë në atë kohë kam pranuar të zgjidhem kryetar i shoqatës me një kusht që kohëzgjatja e kryetarit dhe kryesisë të jetë jo më shumë se një vit. Në fillim çdo gjë ka qenë e vështirë, por tash treni ka filluar të lëvizë. Për shkakë personale (Dua të vazhdoj shkollën, funksionin që kamë në punën time) nuk jam i gatshëm të kandidohem për kryetar të ardhshëm.

Falenderoj gjithë anëtarët e kryesisë për punën e tyre të palodhshme, si dhe çdo anëtar që ka kontribuar në funksionimin e shoqatës.

## **NË TË ARDHMËM**

Dua që edhe pas dhjetë viteve shoqata të jetë ashtu si sot: e qëndrueshme në një bazë të shëndoshë financiare, me një infrastrukturë profesionale.

Faleminderit



Agron Zahiri

Kryetar i shoqatës 17shkurti.ch